



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Nr. 01-112/02-1032
Datë: 08.01.2026

Kryetari i Komunës së Gjakovës, duke u bazuar në nenin 13 dhe nenin 58 pika (b) të Ligjit numër 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 35 të Ligjit numër 08/L-197 për Zyrtarët Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin numër 08/L-294, nenin 9 të Ligjit numër 08/L-294 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit numër 08/L-197 për Zyrtarët Publik, me qëllim të mbarëvajtjes së punëve në Sektorin për Financa, me datë 08.01.2026. nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Nëpunësja **Dardane Riza**, e sistemuar në punë Zyrtare e Lartë për Raportim Financiar, **caktohet ushtruese e detyrës së Udhëheqësit të Sektorit për Financa**, që të punoj me kompetenca të plota, sipas koeficientit **7.26 (GJ3)** duke filluar nga data **09.01.2026**.
2. E emëruara si në piken 1 të këtij vendimi, ushtron detyrat dhe përgjegjësitë si më poshtë:
 - 2.1. Udhëheqë punën e gjithmbarshme të sektorit, menaxhon me stafin e sektorit dhe bën ndarjen e detyrave tek varësit e saj, ofron udhëzime dhe monitoron punën e stafit për të siguruar produkte dhe shërbime cilësore deri në përmbushjen e planit të punës dhe objektivave të përcaktuara. Gjithashtu, bën vlerësim të rregull të stafit nën mbikëqyrje të saj dhe përkrahë zhvillimin e tyre përmes trajnimeve për të siguruar kryerjen e detyrave të tyre në nivel me standardet e kërkuara.
 - 2.2. Menaxhimi dhe ekzekutimi buxhetit komunal.
 - 2.3. Në bashkëpunim me drejtorin, bën vlerësimin e proceseve dhe procedurave të brendshme dhe rekomandon ndryshime dhe përmirësime me qëllim të rritjes së efikasitetit dhe cilësisë së punës.
 - 2.4. Në bashkëpunim me drejtorinë bënë ekzekutimin e pagesave.
 - 2.5. Përgatitja e Raportit vjetor Financiar me analizë mbi të hyrat dhe shpenzimet vjetore.
 - 2.6. Realizimin e Rekomandimeve të ZAP-it mbi të gjeturat për pasqyrat financiare të Komunës për çdo vit.
 - 2.7. Përgatit Informata Financiare me analizë mbi të hyrat dhe shpenzimet mujore dhe periodike për çdo vit.
 - 2.8. Regjistrimi i të gjitha të hyrave komunale për të gjitha programet buxhetore të Komunës dhe raportimi i tyre.
 - 2.9. Barazimet mujore të hyrave komunale konform dispozitave ligjore dhe Rregulloreve komunale në fuqi.
3. Zyrtari publik nuk mund të caktohet si ushtrues detyre më gjatë se dymbëdhjetë (12) muaj përveç rasteve kur procedura e rekrutimit është shpallur por për arsye objektive pozita nuk është plotësuar. Pozita e lirë nuk mund të zëvendësohet me ushtrues detyre për më gjatë se një periudhë prej dy (2) viteve. Çdo vendim i marrë nga ushtruesi i detyrës pas kalimit të afatit të përcaktuar është i paligjshëm.
4. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Ardian Gjini

Ardian Gjini
Kryetar i Komunës së Gjakovës



Vendimi iu dorëzohet:

- Nëpunëses Dardane Riza
- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
- Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore
- Arkivit